



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punje/Prodato Received/Delivered	03.03	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHEK	2340/2023		1/3	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.94/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.94/2023, të datës 18.01.2023, të parashtruar nga ankuesi

kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen administrative-juridike “Kompensim Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 03.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr.94/2023 e datës 18.01.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar “Asistent për transportimin e dokumenteve” në Departamentin e Administratës Qendrore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 09.11.2022 me numër protokolli 1427 ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme për kompensimin e një page me rastin e vdekjes së vëllait. Ndërsa me datë 19.12.2022 përmes e-mailit zyrtar [personeli.mpb@rks-gov.net](mailto:personeli.mpb@rks-gov.net) Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e ka njoftuar ankuesin se kjo kërkesë nuk është proceduar duke u bazuar në vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që të njëjtit nuk kanë dëshmi se kanë qenë në bashkësi familjare.

Ankuesi i pakënaqur, më datë 18.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 462/2023 të regjistruar me numër A.nr.94/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit përmes e-mailit zyrtar të datës 19.12.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.01.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli me datë 14.02.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 1731/2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me nr. protokollit 462/2023 të datës 18.01.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga [personeli.mpb@rks-gov.net](mailto:personeli.mpb@rks-gov.net) për I.S. i datës 19.12.2022; Kërkesë për kompensim për anëtarin e ngushtë të familjes me numër protokollit 1427 i datës 09.11.2022; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile e me numër E 26609579 i datës 01.11.2022; Certifikatë e vdekjes e me numër V 10542180 i datës 24.10.2022; Deklaratë për bashkësinë familjare e me numër F 11384348 i datës 04.11.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 1156/2023 i datës 31.01.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 1731/2023 i datës 14.02.2023; Kërkesë për pushim mjekësor i datës 17.01.2023; Fletëlëshim nga SHSKUK me numër 2548; Akt Emërim i me Nr. Ref: DAQ/ZSP 11/13 i datës 27.03.2013;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit për kompensimin e një page me rastin e vdekjes së vëllait, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pretendimet e ankuesit janë në kundërshtim me Ligjin Nr.2004/32 për Familjen e Kosovës, përkatësisht nenin 271 ku përcaktohet se: *“Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji”.*

Prandaj në kohën e parashtrimit të kërkesës dhe ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi ka ofruar dëshmi certifikatën e vdekjes me nr. V10542180 të datës 24.10.2022 me të cilin dëshmohet se vëllai ka vdekur me datë 06.10.2022, ndërsa ankuesi ka ofruar si provë deklaratën për bashkësinë familjare F11384348 të datës 04.11.2022 në të cilën vërtetohet se nuk ka jetuar me të ndjerin.

Andaj nisur nga këto fakte, Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka ofruar fakte relevante sa i përket bashkësisë familjare të përkufizuar sipas Ligjit nr. 204/32 për Familjen në Republikën e Kosovës, në momentin e vdekjes së të ndjerit (vëllait), kështu që në mungesë të kësaj Kolegji konstaton se është i pabazuar pretendimi i ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha provat dhe faktet relevante dhe ka konstatuar gjendjen faktike dhe juridike ka vendosur për refuzimin e ankesës së ankuesit për shkak të mungesës së provave (mungesës së certifikatës për bashkësinë familjare).

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVWËS  
LËNDA ME NUMËR A.nr.94/2022.**

**Rushit KAJTAZI**

Procesmbajtës

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit*
- *Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme ;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe*
- *Arkivitet të KPMSHCK-së*

